

## STATUTI i Shoqatës „Ndhimë Fëmijëve me Kancer”

Ky statut do të të qeveris shoqatën „Ndhimë Fëmijëve me Kancer” në Kosovë, të themeluar në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-134 të Republikës së Kosovës.

### Neni 1 – Emri, forma dhe adresa

- 1.1 Shoqata do të quhet „Ndhimë Fëmijëve me Kancer”.
- 1.2 Ajo mund të njihet edhe si NFK.
- 1.3 Shoqata është jo-qeveritare dhe jo-profitabile, sipas Ligjit nr. 03/L-134 të Republikës së Kosovës.
- 1.4 Shoqata nuk do të bëjë shpërndarjen e çfarëdo fitimi neto ose të profitit të tillë për asnjë individ. Pasuria, të ardhurat dhe profiti i shoqatës nuk do të përdoret për të mbështetur qëllimet qoftë në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo indirekte për asnjërin nga themeluesit, drejtorin, nëpunësin, ndonjë anëtar të shoqatës, ndonjë të punësuar apo donator të OJQ-së.
- 1.5 Ndonjë transaksion në mes të anëtarëve të shoqatës, anëtarve të Bordit, personi ose nëpunësi të organizatë duhet të mbyllet në vlera reale të tregut ose në kushte që janë më të favorshme për organizatën.
- 1.6 Shoqata e ka zyren e saj qendrore në Zona Industriale Veternik p.n., Prishtinë, (ndërtesa e Pronetit).

### Neni 2 – Themeluesit dhe përfaqësimi ligjor

- 2.1 Themeluesit e shoqatës janë:  
Dua Shehu-Gorani, Ulpiana D6/H4 Nr.8, Prishtinë  
Mimoza Shehu-Musa, Veternik pn, Prishtinë  
Florina Skeja, Kodra e diellit Z.P. LAM 6 Nr.7, Prishtinë
- 2.2 Përfaqësuesi i autorizuar është Drejtor Ekzekutiv deri në emërimin e ardhshëm nga Kuvendi. Zëvendës i Përfaqësuesit të shoqatës është njëri prej themeluesve që emërohet nga kuvendi .
- 2.3 Përfaqësuesi duhet të përfaqësojë shoqatën dhe pranojë të gjitha shkresat zyrtare në emër të shoqatës. Ai ose ajo duhet të jetë përgjegjës për informimin e autoriteteve relevante administrative për çfarëdo ndryshimi në shoqatë. Zëvendësi i merr përsipër detyrat vetëm në mungesë të Përfaqësuesit.

### Neni 3 – Qëllimi

- 3.1 Shoqata shërben vetëm për qëllime bamirëse dhe pa interesa fitimi, ajo nuk është për të fituar.
- 3.2 Shoqata është themeluar me qëllim që prindërit në bashkëpunim me specialistët e degës përkatëse të institucioneve universitare të lehtësojnë ndërmarjen e masave terapeutike dhe përkitazi me ato të aplikojnë njohuritë më të reja shkencore gjatë dhe pas kurimit si dhe këshillimi dhe mësimi i mjekimit për fëmijë të sëmurë nga kanceri. Shoqata merret edhe me projekte hulumtuese në lëmin e parandalimit (Prophylax) dhe zbulimit të hershëm të kancerit të fëmijët dhe inicon projekte përaktëse hulumtuese me qëllim të përpunimit të metodave të reja të

terapisë në hashkëpunim të ngushtë me specialistët e klinikave universitare të kësaj lëmie. Veç kësaj, shoqata përkrah trajtimin dhe kujdesjen ndaj fëmijëve të sëmurë nga kanceri nëpërmjet metodave të përshtatshme financiare.

3.3 Për ta përmbushur misionin e saj, NFK do të ndërmarrë, por nuk do të kufizohet vetëm në to, aktivitete që përshkruhen në vazhdim:

- organizimi i prezentimeve, seminareve dhe ligjeratave nga ana e mjekëve me përvojë për prindërit që kanë përjetuar raste të kancerit tek fëmijët e tyre;
- aktivitete që ndihmojnë të arrihen rezultate në punët hulumtuese si dhe implementim të projekteve përkatëse të hulumtimit dhe zhvillimit të metodave për parandalim dhe zbulim të hershëm të kancerit si dhe për terapi adekuate për fëmijë të sëmurë nga kanceri;
- ndihmon në shkëmbimin e informatave dhe përvojave në mes të mjekëve, pacientëve dhe prindërve të afektuar për secilin rast të sëmundjes dhe mbledhjen e të dhënave që dokumentohen duke e ruajtur identitetin e pacientit në konfidencialitet. Këto të dhëna do të shërbejnë si bazë për përpunimin e orientimeve të reja të terapisë për mjekimin e fëmijëve të sëmurë nga kanceri edhe jashtë klinikës dhe si bazë për punë hulumtuese.

#### **Neni 4 – Anëtarësimi**

- 4.1 Anëtarësimi në shoqatë është i hapur për çdo person pa marrë parasysh racën, gjininë orientimin seksual, shtetësinë, kombësinë, religjionin, moshën apo aftësitë fizike.
- 4.2 Niveli i anëtarësimit është 10 EUR në vit. Mospagesa e anëtarësisë, pas paralajmërimit në të shkruar, do të shërbej si bazë për përjashtimin e anëtarit nga shoqata.
- 4.3 Anëtarësimi i ndonjë anëtari gjithashtu mund të përfundojë ose suspendohet me vendimin e Kuvendit të Anëtarëve në rast të mos përkrahjes së interesave të shoqatës ose në qoftë se ka keqpërdorur emrin e Shoqatës NFK.
- 4.4 Përfundimi ose suspendimi i anëtarësimit nga Kuvendi i Anëtarëve do të propozohet nga Bordi Ekzekutiv me shumicë të votave.
- 4.5 Secili anëtar i NFK-së ka të drejtë të votoj në mbledhjen e përgjithshme, si në mënyrë aktive të zgjedhjes poashtu edhe në mënyrë pasive.
- 4.6 Anëtarët janë të detyruar të kontribuojnë aq sa parashihet me nenin 4.2, çdo vlerë mbi këtë do të konsiderohet donacion nga anëtarët.
- 4.7 Anëtarët obligohen të përkrahin interesat e shoqatës.
- 4.8 Pas paraqitjes së kërkesës me shkrim Bordit Ekzekutiv secili anëtar i shoqatës është i lirë të braktis shoqatën.
- 4.9 Bordi Ekzekutiv ka të drejtë të propozojë për përjashtim nga shoqata anëtarët të cilët shkaktojnë dëm në relazimin e misionit të shoqatës.
- 4.10 Anëtarët të cilët e kanë braktisur, janë fshirë ose janë përjashtuar nga shoqata nuk kanë kurrfarë të drejte të kërkojnë kthimin e pagesës së anëtarësisë dhe nuk mbajnë kurrfarë të drejtash mbi pasurinë e shoqatës.

## **Neni 5 – Kuvendi i Anëtarëve**

- 5.1 Kuvendi i Anëtarëve është organ më i lartë qeverisës i organizatës. Ai përbëhet prej të gjithë anëtarëve të shoqatës.
- 5.2 Kuvendi i Anëtarëve ka përgjegjësinë për mbikëqyrjen në arritjen e misionit të shoqatës dhe kontrollin e punës së Bordit.
- 5.3 Kuvendi i Anëtarëve sipas statutit, ka kompetenca të zgjedhë anëtarët e Bordit Ekzekutiv, ti aprovoj raportet njëvjeçare nga Bordi Ekzekutiv dhe të aprovoj investimet që ndihmojnë në arritjen e misionit të shoqatës .

## **Neni 6 – Mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve**

- 6.1 Kuvendi i Anëtarëve do të takohet së paku dy herë në vit në Mbledhjen e Përgjithshme (MP) ku do të vlerësojnë raportet njëvjeçare nga Bordi dhe aprovon politikat dhe strategjitë për vitin vijues.
- 6.2 Kuvendi i Anëtarëve mund të takohet gjithashtu edhe në Mbledhjen e Përgjithshme të Jashtëzakonshme (MPJ) kurdoherë që kërkohet nga gjysma e anëtarëve ose nga Bordi. Një kërkesë e tillë duhet ti drejtohet Sekretarit i cili do të lajmëroj për takim të gjithë anëtarët, në pajtim me procedurat të shpjeguara në paragrafin 6.3.
- 6.3 Lajmërimi me shkrim për MP ose MPJ duke përfshirë datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, së bashku me rendin e ditës për takimin do tu shpërndahet të gjithëve deri në shtatë ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes.
- 6.4 Për mbajtjen e mbledhjes nevojitet që të jenë prezent së paku gjysma e anëtarëve + 1. Nëse ky minimum nuk arrihet takimi do të shtyhet për një ditë të përcaktuar më vonë dhe lajmërimi i ri do tu dërgohet të gjithë anëtarëve.
- 6.5 Secili anëtarë i shoqatës ka një votë në Kuvendin e Anëtarëve.
- 6.6 Vendimet në Kuvendin e Anëtarëve do të merren me shumicën e anëtarëve prezent.
- 6.7 Secili anëtar i Kuvendit të Anëtarëve mund të abstenojë nga votimi ose marrja e vendimit në çfarëdo çështje për të cilën ai ose ajo ka pikëpamje tjetër nga shumica.

## **Neni 7 – Bordi i Nderit**

- 7.1 Bordi i Nderit do të jetë i përbërë nga personalitetet të propozuar nga Bordi Ekzekutiv dhe të nga emëruar nga kuvendi i Shoqatës NFK.
- 7.2 Bordi i Nderit përbëhet nga përfaqësues të donatorëve të mëdhenj të NFK dhe personave eminent vendor dhe ndërkombëtarë.
- 7.3 Bordi i Nderit takohet së paku një herë në vit me Bordin Ekzekutiv me detyrë që të shqyrton situatën në NFK dhe të rishqyrtohen buxhetet, projektet dhe aksionet që janë ndërmarrë dhe duhet të ndërmerren në mënyrë që të arrihen objektivat e vitit vijues.
- 7.4 Në rastet e jashtëzakonshme mbledhjen e Bordit të Nderit e thërret Përfaqësuesi i autorizuar ose Zëvendësi ashtu si rregullohet në nenin 2.

- 7.5 Bordi i Nderit me kërkesë nga Bordi Ekzekutiv ka të drejtë të marrë vendime për investime në projekte që janë jetike për arritjen e misionit të NFK deri në vlerë prej 100,000 EUR.
- 7.6 Bordi i Nderit kryesuesin e zgjedh në mes të anëtarëve të vet. Ky Bord duhet të ketë numër tek të anëtarëve dhe nuk mund të kalon numrin njëmbëdhjetë.
- 7.7 Në rast të vdekjes ose dorëheqjes të ndonjë prej anëtarëve vet anëtarët e Bordit vendosin për anëtarin e ri.
- 7.8 Vendimet në Bordin e Nderit merren me shumicë dhe për këtë mbahet procesverbali.
- 7.9 Anëtarët e Bordit të Nderit janë të autorizuar të llobojnë për NFK.
- 7.10 Anëtarët e Bordit të Nderit nuk do të kompensohen për punën dhe aktivitetet e tyre.
- 7.11 Secili anëtarë i Bordit të Nderit mund të abstenojë prej votimit për marrjen e vendimeve ose për çfarëdo çështje tjetër për të cilën ai ose ajo ka çëndrim ndryshe prej të tjerëve.

#### **Neni 8 – Bordi Ekzekutiv dhe Grupi Etik**

- 8.1 Bordi Ekzekutiv përbëhet nga 5 anëtarë e që duhet të jenë: një mjek nga Reparti Hematologjik, Klinika Pediatrike në QKUK, dhe 4 prindër anëtarë të NFK. Anëtarët e Bordit Ekzekutiv emërohen nga Kuvendi i Anëtarëve.
- 8.2 Bordi Ekzekutiv udhëheqë me punët ditore të NFK dhe ka të drejtë që të marrë vendime për investim në realizimin e projekteve që kanë për qëllim përmbushjen e misionit të NFK deri në vlerë prej 5,000 EUR, dhe për këtë i raporton kuvendit.
- 8.3 Bordi ekzekutiv raporton së paku dy herë në vit ndaj Bordit të Nderit dhe Kuvendit të Anëtarëve pas përfundimit të viti kalendarik e jo më larg se java e dytë muajit Mars i vitit të ardhshëm. Përpilimi i raportit për aktivitetet e NFK bëhet nga Përfaqësuesi dhe/ose Zëvendësi siç parashihet me Nenin 2 të këtij Statuti.
- 8.3 Në kuadër të Bordit Ekzekutiv do të funksionon edhe Grupi Etik i cili përbëhet nga të njëjtët anëtarë si Bordi Ekzekutiv por asnjëri prej tyre nuk guxon të jetë Përfaqësuesi apo Zëvendësi. Grupi Etik do të përbëhet nga tre persona të Bordit Ekzekutiv.
- 8.4 Grupi Etik vendos për rastet të cilat duhet të përkrahen materialisht nga NFK si mbulimi i shpenzimeve të analizave laboratorike dhe të ngjajshme. Këtë përkrahje e bën përmes sistemit voucher që rregullohet nga Grupi Etik. Vaçheri vlen vetëm me të gjitha nënshkrimet nga Grupi Etik.
- 8.5 Grupi Etik ka për detyrë të përcaktojë kriteret dhe procedurën në bazë të së cilës do të funksionon. Aprovimin e kriterëve dhe procedurës e bën Bordi i Nderit në një mbledhje të jashtëzakonshme të thirrur nga Bordi Ekzekutiv.
- 8.6 Grupi Etik takohet add-hoc sipas nevojës dhe kërkesave nga Sekretari.

## Neni 9 – Zyrtarët dhe Nëpunësit

- 9.1 Në rast nevoje Bordi i Ekzekutiv do të emërojë Zyrtarë ose të pranojë persona që të marrin përsipër kryerjen e detyrave ditore dhe administrative të shoqatës (si psh. Sekretari). Kohëzgjatja e angazhimit/punësimi të tyre duhet të caktohet nga Bordi Ekzekutiv, këtë do aprovoj kuvendi.
- 9.2 Zyrtarët duhet të angazhohen/punësohen përmes marrëveshjes së shkruar e cila detalizon të gjitha të ardhurat dhe të mirat e tjera që duhet t'i paguhet Zyrtarit. Të gjitha pagesat duhet të jenë të arsyeshme dhe duhet të paguhet vetëm punë e kryer për shoqatë.

## Neni 10 – Shpërbërja e shoqatës

- 10.1 Shpërbërja e shoqatës mund të bëhet kur thirret një mbledhje jo e rregullt e përgjithshme vetëm për këtë qëllim dhe vendoset me votimin me shumicë të anëtarëve të Kuvendit.
- 10.2 Nëse eventualisht shoqata përfundon së ekzistuari ftohet kuvendi i për të vendosur për këtë. Kur të vendoset për shpërbërjen e organizatës, kuvendi i anëtarëve do të tregoj emrin e shoqatës ose fondacionit që do të marrë pasurinë e mbetur pasi të jetë liruar nga detyrimet e shoqatës. Shoqata(t) ose fondacioni(et) e zgjedhura duhet të kenë qëllime të njejta ose të ngjajshme sikurse NFK dhe se veprimtaria e tyre nuk ka qëllim profitin por vetëm aktivitete bamirësie ose humanitare.
- 10.3 Pasuria që mbetet në momentin e shpërbërjes së shoqatës trajtohet ashtu si parashihet nën Nenin 3.1.

## Neni 11 – Ndryshimet e statutit

- 11.1 Statuti i tanishëm mund të ndryshohet me vendimin e dy të tretave të shumicës së Kuvendit të Anëtarëve të pranishëm në seancë.

## Neni 12 – Periudhat e Raportimit dhe Viti Financiar

- 12.1 Bordi Ekzekutiv do të përgatit raporte sipas kërkesave ligjore. Bordi Ekzekutiv do të paraqes raporte vjetore para Kuvendit të Anëtarëve në MP ose kurdoherë që kërkohet nga një MPJ.
- 12.2 Viti financiar i organizatës do të përputhet me vitin kalendarik.

## Neni 13 - Sigurimi i mjeteve

- 13.1 Shoqata siguron mjetet nëpërmjet anëtarësisë, donacioneve, mbledhjeve dhe eventualisht nëpërmjet të subvencioneve nga shoqatat e ndryshme.

Ky statut është aprovuar në Prishtinë. Më 03/06/2011.

Nënshkruar nga:

*Ilir Gorani*  
*Adil Hoxha*  
*Alban*  
*Shumaj*

